

Dalja nga kriza vetëm përmes zgjedhjeve të reja (botuar në gazetën "Koha Ditore", më 20 dhjetor 2010)

Dialog nga "Duke pritur Godonë":

Vladimir: --A është e mundur që ke harruar tashmë?

Estragon: --Kështu jam unë. Ose harroj menjëherë ose nuk harroj kurrë.

Populli i Kosovës e ka mundësinë e heshtjes dhe harresës së menjëhershme, ose të ngritjes së zërit duke mos pranuar të harrojë kurrë për krimin e organizuar zgjedhor që ndodhi me 12 dhjetor. FER-i konsideron se e vetmja mënyrë e daljes nga kriza e demokracisë e shkaktuar nga politika e vjetër është organizimi i zgjedhjeve të reja në shkallë vendi.

Është e vërtetë se në disa vendvotime pati shkelje më të mëdha se në të tjerat, por është e pamohueshme që shkeljet zgjedhore ndodhën në tërë Kosovën, duke përfshirë Prishtinën, dhe ato ishin të ndihmuara ose të orkestruara nga politika e vjetër.

Problemet e dokumentuara me zgjedhjet e fundit, nga ato teknike deri tek ato të votimit të shumëfishtë, prishjes së fletvotimeve, ndërrimit të kutive, kërcënimit e presionit, madje edhe blerjes së votës, e bëjnë 12 dhjetorin një datë antidemokraci për Evropën Juglindore. Zgjedhjet e fundit e shkelën direkt edhe Kushtetutën e Kosovës, më saktësisht nenin 45.2, i cili kërkon që "vota të jetë personale, e barabartë, e lirë dhe e fshehtë." Kutitë votuese anekënd Kosovës u mbushën fshehurazi me vota të cilat nuk ishin as personale, as të barabarta dhe as të lira.

Interesi ynë kombëtar mund të dërgohet përpara nga politika që e kupton se si funksionon bota perëndimore, duke i ndihmuar Kosovës që të arrijë standarde evropiane, e jo nga politika që në retorikë ka qenë e nuk është më nacionaliste, por që në realitet na pamundëson të dalim jashtë statusit të vrimës së zezë evropiane. Çfarëdo qeverie që del nga zgjedhjet e manipuluar do të ishte e palegjimitet dhe nuk do të kishte mundësi ta dërgonte vendin tonë përpara.

Kosova dhe qytetarët e saj janë sprovuar shumë herë në të kaluarën. Ne jemi ngritur sa herë që na kanë rrëzuar. Më 12 dhjetor, një pjesë e politikës së vjetër është munduar ta çrrënjosë plotësisht sistemin edhe ashtu të brishtë demokratik, duke deformuar vullnetin e popullit. Sot, kemi mundësi ta kundërshtojmë këtë deformim, që të ngritemi prapë, për ta filluar një etapë të re në historinë tonë. Kjo ngritje bëhet vetëm përmes zgjedhjeve të reja në tërë territorin e Kosovës.

Përsëritja e zgjedhjeve është kompetencë e KQZ-së, në bazë të nenit 106.2, të Ligjit për Zgjedhjet e përgjithshme, i cili thotë se para certifikimit të rezultatit të zgjedhjeve, "KQZ-ja mund të urdhërojë rinumërimin e votave në cilindo vendvotim, qendër të numërimit ose edhe përsëritjen e votimit" në një qendër votimi apo në një komunë (ose në më shumë komuna, siç ka ndodhur tash). Zgjedhjet e reja do të vëzhgoheshin nga monitorues statikë ndërkombëtarë, e

jo vetëm nga OJQ vendore, kredibiliteti i shumë prej të cilave është dëmtuar seriozisht e në disa raste në mënyrë të pariparueshme.

Ka akte dhe procese që janë përmbi një parti politike, dhe nëse stabiliteti ka qenë faktori më i rëndësishëm deri tash, atëherë ai nuk mund të ruhet nga një keqqeverisje që mban përgjegjësi edhe për keqpërdorim votash. Tash është evidente se jostabiliteti prodhohet nga të njëjtit që keqqeverisën, andaj stabiliteti tani e tutje mund të garantohet vetëm nga politika e re. Kërcënimi i stabilitetit sot nuk është më kryekëput tensioni etnik, por varfëria, papunësia dhe mungesa e demokracisë funksionale.

Përcaktimi ynë për ta parë një Kosovë evropiane, ku ka vende të punës, ku luftohet korrupsioni, ku ka arsim cilësor e pensione adekuate, ku ka sistem funksional shëndetësor dhe ku të gjithë mund të lëvizim lirshëm nëpër Evropë, është dukshëm më i fuqishëm se tentimi i të tjerëve për ta manipuluar të ardhmen e Kosovës.

E pranoj haptas se testi i vetëm i FER-it është qëndrueshmëria. Disa na shikojnë me nëpërçmim duke thënë se “ju as prapun nuk e keni kaluar.” E vërteta është se ata që besojnë se zgjedhjet e 12 dhjetorit ishin të lira dhe fer nuk përbëjnë as 1% dhe assesi nuk do ta kalonin prapun zgjedhor.

FER-i arriti që për dy muaj të pozicionohet qartë në spektrin politik dhe ta pasurojë atë me bashkëbisedim të vërtetë me qytetarë, programe e vizion përmbajtësor. Prandaj, mesazhi është i drejtëpërdrejtë, si për votuesit e përkrahësit tanë, si për partitë e tjera politike: FER-i e vazhdon misionin e vet, i forcuar nga vota, i dëmtuar, sikurse Kosova, nga parregullsia e procesit votues, por mbi të gjitha i palëkundur në vendosmërinë për ta mbrojtur demokracinë e shtetit tonë të ri.